

PËRCEPTIMI I NXËNËSVE, MËSIMDHËNËSVE, PRINDËRVE PËR  
GJITHËPËRFSHIRJËN NË ARSIM NË KOMUNËN E ISTOGUT

TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I SOCIOLOGJISË

NGA

ALBENITA MEHAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË  
STUDIME PASUNIVERSITARE - MASTER

PRISHTINË  
2022

## REZYME

# "PËRCEPTIMI I NXËNËSVE, MËSIMDHËNËSVE, PRINDËRVE PËR GJITHËPËRFSHIRJËN NË ARSIM NË KOMUNËN E ISTOGUT"

### **Mentori:**

Prof. Ass. Dr:Fadil Maloku

Gjithëpërfshirje në arsim është kur i ofrohet gjithë fëmijëve të marrin pjesë në procesin mësimor në mënyrë të barabartë, duke përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta apo me ndonjë vështirësi në të nxënë, fëmijët e të gjitha komuniteteve, ata që jetojnë në zonat e deprivimit social ose ekonomik dhe të gjithë fëmijët e kulturave të ndryshme. Hulumtimi i temës "Përceptimi i nxënësve, mësimitdhënësve, prindërve për gjithëpërfshirjën në arsim në Komunën e Istogut", ka për qëllim për të parë se a ka krijuar Komuna e Istogut praktika të mira të gjithëpërfshirjës në arsim.

Gjithëpërfshirja në arsim është një fenomen shumë i rëndësishëm për jetën e fëmijëve poashtu, edhe një fenomen shumë i rëndësishëm shoqëror. Arsimit gjithëpërfshirës varet prej shumë faktorësh siç është puna e mësuesve në klasë, asistentëve, drejtorit/ja e shkollës, prindërve, nxënësve si dhe prej shumë elementëve të tjerë jashtë shkollës. Gjithëpërfshirja në arsim është bërë realitet edhe në vendin tonë mirëpo, ende është e shoqëruar më vështirësi të shumta. Disa vështirësi që pengojnë zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës janë si p.sh mospërfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta, infrastruktura jo e përshtatshme në shkollë, mosbarazia për nxënësit që vijnë nga kultura të ndryshme, fetare, etnike, shtresa të ndryshme sociale, mosbarazisë gjinore për të vijuar shkollën etj.

Dihet se qëllimi i arsimit gjithëpërfshirës është të sigurojë që të gjithë nxënësit të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të kenë mundësi të barabarta në procesin arsimor pavarësisht dallimeve që ekzistojnë në mes nxënësve. Atëherë qëllimi i këtij punimi është që përmes të dhënave të mbledhura nga hulumtimi të kuptojmë se çfarë praktikash ka krijuar Komuna e Istogut sa i përket arsimit gjithëpërfshirës. Hipoteza kryesore e hulumtimit është: Shkollat në Istog kanë krijuar praktika shumë të mira të gjithëpërfshirjës në arsim.

Fjalët kyçe: Nxënës, Gjithëpërfshirje, Përceptim, Prind, Mësimitdhënës.

## **Struktura e punimit**

Në **hyrje** të këtij punimi janë shtjelluar motivet e zgjedhjes së temës, qëllimi i hulumtimit, hipotezat dhe pyetjet ndihmëse, metodologjia dhe instrumentet, mostra, çfarë rëndësie shkencore dhe shoqërore ka ky punim, procedurat, struktura e punimit.

Në **pjesën e II** të këtij punimi përfshihet se çfarë kuptimi ka gjithëpërfshirja në arsim dhe cili është qëllimi i një mjedisi gjithëpërfshirës në shkolla. Sqarohet se si proces kur ka filluar për herë të parë arsimi gjithëpërfshirës. Të gjithë fëmijët duhet të jenë të pranuar pavarësisht dallimeve dhe trajtohën barabartë si nga mësimdhënësit, stafi i shkollës, nxënësit e tjerë. Në këtë pjesë është sqaruar se ku qëndron dallimi në mes të nocionit gjithëpërfshirje në arsim dhe integrim pasiqë shpeshherë këto dy nocione konsiderohen si të njëjta mirëpo dallojnë shumë në mesvete. Trajtohet se çka e karakterizon një klasë gjithëpërfshirëse si dhe cilat janë pengesat kryesore për zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës. Në këtë pjesë përfshihen edhe ligjet dhe konventat që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen në arsim, politikat e MASHT-it për arsimin gjithëpërfshirës, profili i një mësimdhënësi gjithëpërfshirës, si dhe sqarohet rëndësia e bashkëpunimit të shkollës me prindërit.

Në **pjesën e III** të këtij punimi përfshihet "**Përceptimi i nxënësve për gjithëpërfshirjen në arsim në Komunën e Istogut**", paraqiten të dhënat e mbledhura nga hulumtimi që është zhvilluar në shkollat fillore të Komunës së Istogut me 200 nxënës. Përmes këtyre pyësorve janë mbledhur të dhëna sasiore. Të dhënat e mbledhura janë paraqitur në grafikone si dhe është bërë analiza për secilën pyetje.

Në **pjesën e IV** përfshihet "**Përceptimi i mësimdhënësve për gjithëpërfshirjen në arsim në Komunën e Istogut**". Mësimdhënësit janë kushti kryesorë që një shkollë të jetë gjithëpërfshirëse. Mësimdhënësi duhet të dijë si të punoj dhe të iu përshtatet stileve të ndryshme të të nxënit në atë klasë që punon. Nxënësit duhet të kuptohen, pranohen dhe vlerësohen pavarësisht dallimeve që ekzistojnë në mes nxënësve. Në këtë pjesë paraqiten të dhënat e mbledhura nga hulumtimi që është mbajtur në shkollat fillore të Istogut me 100 mësimdhënës.

Në pjesën e V të këtij punimi paraqitet "**Përceptimi i prindërve për gjithëpërfshirjen në arsim në Komunën e Istogut**". Në hulumtimin që është bërë në shkollat fillore të Istogut kanë marrë pjesë 50 prindër. Secila përgjigje e tyre është analizuar dhe janë nxjerrur të dhënat përfundimtare.

**Pjesa e VI-** përfshinë pjesën e përfundimeve. Këto përfundime mbështetën në të dhënat e mbledhur nga hulumtimi që është zhvilluar në shkollat fillore të Komunës së Istogut. Gjithashtu në këtë pjesë janë dhënë edhe disa rekomandime sa i përket gjithëpërfshirjes në arsim që do të ndihmonin që të zhvillohet një mjedis gjithëpërfshirës nëpër shkolla. Kjo pjesë përmban edhe literaturën dhe burimet e ndryshme si dhe shtojcat.

## **Metodologjia**

Kapitulli që ka të bëjë me gjithëpërfshirjen në arsim është realizuar përmes literaturës, ligjeve, raporteve të ndryshme për gjithëpërfshirjen në arsim si dhe burimeve të tjera. Për kapitujt që kanë të bëjnë me përceptimin e nxënësve, mësimitdhënësve, prindërve për gjithëpërfshirjen në arsim është përdorur metoda sasiore përmes pyetësorit ku është zhvilluar hulumtim në shkollat fillore në Komunën e Istogut që për fokus ka tri grupe; nxënësit, mësimitdhënësit dhe prindërit.

Për këtë hulumtim instrumenti që është përdorur është pyetësori ku janë nevojitur tre pyetësor: nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve. Përmes këtij hulumtimi është matur çfarë praktikash ka krijuar Komuna e Istogut sa i përket gjithëpërfshirjes në arsim.

